

FJALA E DEPUTETES SHPRESA MARNOJ

E HENE 14 SHTATOR 2023

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në këtë pikë të rendit të ditës shqyrtojmë projektligjin “Për miratimin e rezolutës nr. 463/2022 të bordit drejtues të Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim”, i cili është diskutuar në komisionet parlamentare, ku Komisioni për Ekonominë dhe Financat e ka shqyrtuar në cilësinë e komisionit përgjegjës. Qëllimi i projektligjit është përmbushja e detyrimeve të shtetit shqiptar kundrejt institucioneve financiare ndërkombëtare, ku, pikërisht, Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës ka një rol të veçantë dhe mjaft të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të programit të qeverisë shqiptare. Ashtu si çdo vend tjetër anëtar pranë këtij organizmi financiar, edhe Shqipëria, që ka aderuar në dokumentin bazë të CEB-it që në vitin 1999, duhet të pranojë kushtet dhe afatet e rezolutave të bordit drejtues të bankës, ku vendi ynë zotëron 13 mijë e 385 aksione, me një vlerë prej 13 milionë e 385 mijë euro. Më 2 dhjetor të vitit të kaluar, bordi drejtues i CEB-it miratoi rezolutën nr. 463 me objekt: rritja e kapitalit të nënshkruar të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës në shumën 4,25 miliardë euro. Në zbatim të kësaj rezolute, Shqipëria ftohet të nënshkruajë certifikatat e reja të pjesëmarrjes me vlerë 10 milionë e 386 mijë euro. Në përmbajtjen e këtij projektligji janë të gjitha detajet teknike: shtojca dhe tabela për procedurat e ndjekura fillimisht, gjendja e kapitalit para dhe pas rritjes së tij, afatet e përcaktuara qartë të pagesave të kësteve, të cilat janë të ndara në katër, si dhe datat kur rritja e kapitalit hyn në fuqi për çdo vend anëtar. Duke qenë se projektligji është mjaft teknik, unë do të ndalem më shumë te rëndësia dhe efektet financiare të tij në buxhetin e shtetit. Ky projektligj ka një kosto financiare në buxhetin e shtetit për vitin 2023 në shumën 2 milionë e 933 mijë euro, fond që do të paguhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë brenda vitit 2023.

Vendi ynë ka qenë dhe do të mbetet përfitues i fondeve të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, si financues ose bashkëfinancues i projekteve të ndryshme të zbatuara në fushën e kohezonit social, ku vlera e përfituar nga këto fonde llogaritet të jetë rreth 237 milionë euro në sektorë mjaft jetikë dhe prioritarë, siç janë: arsimit, shëndetësia, emergjencat dhe COVID-19, që zënë peshën më të madhe të financimit, por edhe në sektorët e transportit apo të strehimit, sidomos në kuadër të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore. Më e rëndësishme është që këto grante dhe hua janë përftuar me terma lehtësues. Mjafton që të përmendim këtu mbështetjen buxhetore dhe disbursimet e vitit 2022 në vlerën e 60 milionë eurove, si një mbështetje në kushtet e nevojave të shtuara për financim, ku tregjet financiare përsuan luhatje të ndjeshme për arsye që tashmë dihen, nga goditjet dhe zhvillimet e njëpasnjëshme me të cilat u përball ekonomia globale, natyrisht edhe ekonomia jonë, duke vënë çdo sektor në vështirësi financimi apo likuidimi. Gjithashtu, financimet që priten të jepen nga ky institucion do të vijojnë të përfitohen me terma më të favorshëm se termat tregtarë normalë; do të jenë në përputhje me kapacitetet e institucioneve shqiptare për të përthithur financime për projekte të ndryshme apo edhe të huave në formën e mbështetjeve buxhetore për politikën apo reformat e caktuara të qeverisë, të cilat po ndikojnë në transformimin e infrastrukturës në të gjithë vendin, në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, në zhvillimin e ekonomisë dhe në përmirësimin gradual të çdo sektori në përgjithësi. Në përfundim, duke vlerësuar ligjshmërinë e këtij projektligji, si në aspektin kushtetues, edhe në atë procedural, si dhe rëndësinë që ai ka për vendin tonë, ju ftoj të gjithëve ta miratojmë.

Faleminderit!